

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Video - Berisha-ministres së Shëndetësisë: Shko e pi kafe me Karçanajn të mbledhësh mendjen! Jep do rëheqjen, ke futur Lindën e Surrelit aty
ADRESA	https://www.syri.net/politike/917339/berisha-ministres-se-shendetesise-shko-e-pi-nje-kaf-e-me-karcanajn-qe-te-mbledhesh-mendjen-jep-doreheqjen-se-ke-futur-linden-e-surrelit-aty/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 12:01:51 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 11:58:54 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ab17e6eeaa8d25dde1d5c5c5b515c5d54eea9d5e7b1fbc08fc1832adee696299
TEKSTI	922fb41411565918a5d09e451a603df3610a752766fecae17ed0d83ff127988a
PAMJA	213f9ae8e1e0780be5724654fe1761972f5893f7781706cc4341b4c2709426ad

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	8e501fde37c416c521d8393380f34d92d73ff0d91d1e3436a9d0a860be4ec119
E MËPARSHMJA	f62dd8185d27165c2e3716c605b37028be18bff5d76cbda23be7472be228530e
RRËNJA MERKLE	c459fbdf88f453b54a4131a2c6b72ae8533f09b2deef09d60e250bd91e1b553d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/8e501fde37c416c521d8393380f34d92d73ff0d91d1e3436a9d0a860be4ec119>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**PROF. MYQEREM TAJ**

Shqipëria e harruar fillon aty ku shkolla mbetet pa nxënës!

**SONILA MEÇO**

'Në emër të popullit të Kosovës', prokura e një kurthi

LAJMI I FUNDIT

LIVE - Seancë plenare dhe protesta! - Berisha deklaratë për median para Kuvendit

më të lexuarat

'Akuza të stisura politikisht', Saiti:
Dënimi i krerëve të UÇK, jo në emër të Kosovës

Zhupa: Nga shkollat me turne te emigrimi i të rinjve, problemet mbeten të njëjta, fëmijët paguajnë çmimin

Specialja: Të akuzuarit vepruan së bashku për një qëllim të përbashkët kriminal, Thaçi ishte anëtar kyç

Nafta këtu më shtrenjtë se në Europë, Bozdo: Situata, emergjente! Qeveria të ndërhyjë me lehtësira fiskale

A e ndryshon vendimi i Hagës mënyrën si duhet parë UÇK-ja? Flet historiani Konrad Clewing! Faji individual, lufta e Kosovës dhe kufijtë...

'Thaçi kishte dijeni për krimet, Veseli



Berisha-ministres së Shëndetësisë: Shko e pi kafe me Karçanajn të mbledhësh mendjen! Jep dorëheqjen, ke futur Lindën e Surrelit aty

13:58, 17/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Nga foltorja e Kuvendit lideri i PD-së, Sali Berisha i kërkoi ministres së Shëndetësisë Klodiana Spahiu të japë dorëheqjen.

Berisha deklaroi se skema e operatorit të Shërbimeve të Integruara Shëndetësor është skema e vjedhjes më të madhe të të sëmurëve, kjo ishte dhe arsyeja pse ish ministrja Evis Sala e refuzoi dhe dha dorëheqjen.

Ministrja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ishte thirrur në interpelancë urgjente nga deputeti i Partisë Demokratike, njëherësh kryetar i komisionit për Shëndetësinë dhe Mirëqenien Sociale, Bardh Spahia i lidhje me krijimin e Operatorit të Shërbimeve të Integruara Shëndetësor.

Për PD në Operatori i Shërbimeve të Integruara Shëndetësore, nuk është asgjë tjetër, përveçse një mënyrë e re për të grabitur qindra miliona euro të destinuar për pacientët shqiptarë.

Pjesë nga fjala e Berishës

Kësaj zonje që ikën kështu dhe që u betua dhe u stërbetua këtu, duhet t'i them dy fjalë.

Pararendësja juaj, ajo ka qenë një studiuese e rrallë, ua them unë, me punime që po t'u marrësh ju të gjithë së bashku, nuk bëni as një të dhjetën e saj. Në Kembrixh dhe në universitete të tjera.

Në një moment të caktuar, kur thonë ia mori ai mendjen dhe pranoi detyrën e ministres.

E vërteta, me dorëheqjen e saj, ajo mbrojt integritetin e vet, duhet ta them, pavarësisht nga akuzat e lëshuara mbi të, por ajo kur erdhi puna që iu propozua

skema e vjedhjes me te madhe te te semureve, ajo tna miruparshim.

Pasardhësja u betua, u stërbetua këtu, ka vetëm një këshillë, shko dhe pi një kafe jo me Lindën e Surrelit, por me Lindën tjetër. Jo me patronazhisten, por me atë drejtoreshën dhe të të rrëfejë ajo dramën e saj në mënyrë që uroj të mbledhësh mendjen dhe të japësh dorëheqjen një minutë e më parë nga ajo detyrë se fillim më të mbrapshtë nuk mund të kishte se të fusje aty patronazhisten e Surrelit, Lindën e Surrelit, kunati i të cilës është faktikisht strumbullari i të gjithë vjedhjeve të qindra milionë eurove në AKSHI.

Dhe nuk i del emri vetëm se është kunati i Lindës.

Pra, meqë the për disa të dhëna, unë t'i jap ty të sakta fare.

Pa dyshim që sistemi shëndetësor gjithnjë ka nevojë shumë të madhe për t'u përmirësuar, por një gjë kishte, në ato vite Shqipëria renditej e tretë në Evropë për aksesin, pra për mungesën e radhës.

Së dyti, nuk kishte mungesa ilaçesh për sëmundjet malinje sepse në mënyrë absolutisht u bliheshin me çdo kusht.

Së treti, një sistem mbi 100 milionë euro u investua në imazheri.

Pra, nuk them se nuk kishte të meta, por statistikat tregojnë se sot shqiptarët paguajnë 50 përqind më shumë nga xhepi nga sa paguanin në ato vite.

Mos bëj avokatinë e atyre akteve të tmerrshme, ku sterilizimit iu rrit çmimi 83 herë.

Ndaj dhe je shumë folklorike kur del e betohesh këtu se je transparente.

Po si mund t'i dalësh ti zot këtu sterilizimit?

Ka ndodhur si ka ndodhur, po e kanë paguar me qindra jetë.

A e di ti sa vdiqën nga Covid-i?

20 mijë vdekje. Shqipëria u ngjit në çatinë e botës për vdekje.

Dhe ti je mjeke, ti e di fare mirë se ajo erdhi nga mashtrimi i të sëmurëve, nga një sharlatanizëm kriminal që bëhej çdo gjë për të shtruar të sëmurët dhe mbante Shqipëria gjysmën e shtretërve të Covid-it që kishte Kosova.

Pse e lidh veten ti? Pse na bën histori këtu?

Ti e ke marrë përsipër aty, vazhdo me tezaken apo dajaken, çfarë është ajo, kushërira e parë, dhe do shohësh vetë ti.

Por në radhë të parë shko te Karçanaj dhe pi një kafe me të.

© SYRI.net

Lexo edhe:



Vendimi Hagës/ Berisha: Lau duart si Ponc Pilati. Rama përdori Bordin e Paqes për të shpëlarë 'krimin e shëmtuar' ndaj Kosovës



Spahia interpelancë me ministren e Shëndetësisë: Operatori i Shërbimeve të Integruara, skemë korruptive për të grabitur miliona euro



Berisha: Kemi të bëjmë me kontrabandë të mirëfilltë. Blihen armë në zona lufte, Shqipëria paraqitet si vend prodhues

mon pjesë dhe inkurajoi kryerjen e tyre



Ligji për statusin e magjistratëve të hiqet nga rendi i ditës, Bardhi denoncon skandalin: Në Kuvend versioni i ri i pakonsultuar me asnjë...



Muzeu hebraik në Vlorë/ Nezini: Godina i përket Klubit Labëria, po zhduket historia



'Vendimi i Hagës, i pabazuar dhe pa fakte', Veseli: Akuzat, të stisura e fabrikua në Serbi


TË NGJASHME



Balliu në Kuvend: Në një shtet normal prevalon Kushtetuta, në një narkoshtet prevalon vendimi i partisë



Protesta te Kuvendi/ Narko-policia arrestoi me dhunë 11 protestues



VIDEO/ Nuk ndalet revolta qytetare, policia arreston protestuesin simbol, 'djalën e pankartës'



Berisha: Aleksandër Vuçiç dhe argati i tij Edi Rama janë përgjegjës direkt për atë që ndodhi në Hagë

VIDEO/ Protestuesit përmbysin
kazanët e mbeturinave, narko-policia
u sulet qytetarëve

Protesta në Prishtinë/ Studentët
kërkojnë drejtësi për ish-krerët e
UÇK-së

Berisha në Kuvend: Jeni bërë ushtarë
të Padronit dhe Yeffet-it, po i jepni
paratë kompanisë së Edi Ramës

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MJEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do t'i gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.